



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d**, të nenit 17, pika **b**, të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), të nenit 15 të Ligjit nr. 2003/14, për planifikimin hapësinor, të nenit 11 të Ligjit nr. 03/L - 106, për ndryshimin e Ligjit për planifikimi hapësinor dhe të nenit 15, pika 15.1, pika **b** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 31.05.2012, mori

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PLANIT RREGULLUES "ZONA EKONOMIKE" NË
PRISHTINË

I.

Miratohet Plani rregullues "Zona Ekonomike" në Prishtinë.

Plani, nga pika I e këtij vendimi, përfshinë hapësirën brenda kufijve të përcaktuar me pjesën grafike të tij, i cili bashkë me pjesën tekstuale paraqet pjesë përbërëse të këtij Vendimi.

Hapësirat të cilat, si pasojë e ndryshimit të kufirit nga ai i përcaktuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës, 01. nr 35 - 1017, dt. 16.07.2008, për fillimin e hartimit të planit rregullues nga pika I e këtij vendimi, do të trajtohen me vendime të veçanta gjatë hartimit të planeve rregulluese të hapësirave jashtë kufijve të këtij plani rregullues.

II.

Rregullimi dhe realizimi i hapësirës së përfshirë brenda kufijve të Planit rregullues nga pika I e këtij vendimi, do të bëhet nga organi kompetent komunal për punë të planifikimit dhe urbanizmit, përmes kushteve urbanistike - teknike, të përcaktuara me këtë plan, lejeve urbanistike dhe ndërtimore dhe sipas procedurave të parapara ligjore.

III.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës.

Organet tjera kompetente komunale do t'i kryejnë veprimet procedurale nga përgjegjësitë e tyre të caktuara për zbatimin e këtij plani.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi dhe fillon të zbatohet nga dita e dhënies së pëlqimit të komisionit miks të Qeverisë së Kosovës për vlerësimin e ligjshmërisë së këtij Vendimi.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr. 031 - 20131, më 31.05.2012

KRYESUESI I KUVENDIT
Sami Hamiti, ecc. i dipl.